



2017

BULETIN Preportr



PAZARI ME TEMA TË DIPLOMËS

BESNIK BOLETINI, LEONIDA MOLLIQAJ

Shitja dhe blerja e temave të diplomës është një dukuri e përhapur në Universitetin e Prishtinës. Preportr ka hulumtuar këtë treg dhe ka gjetur se nga paaftësia e absolventëve për të përgatitur një temë diplome, po përfitojnë individë të ndryshëm që e kanë bërë shitjen e temave të diplomës një biznes fitimprurës, të cilin edhe e reklamojnë pa hezitim. Për shkak të numrit të madh të temave që mentorohen nga një profesor, shpesh studentët kanë diplomuar me të njëjtin punim pa u vënë re



Një pjesë e studentëve të Universitetit të Prishtinës edhe pse kanë kryer të gjitha provimet nuk janë aftësuar që të përgatisin vetë temën e diplomës. Kjo tregon për cilësinë e studimeve dhe kriteret e profesorëve të UP-së për këta studentë. Por të tillët gjejnë zgjidhje lehtë, sepse të tjerët punojnë për ta.

Duke e marrë parasysh këtë situatë, ka individë që po përfitojnë materialisht duke shitur punime diplome për këtë kategori të studentëve. E për t'i gjetur këta shitës nuk është fare e vështirë. Mjafton të kërkosh në rrjetet sociale, apo në web-faqe të marketingut ku gjen me dhjetëra mundësi për ta blerë temën e diplomës.

Ekipi i Preportr ka hulumtuar tregun e shitjes së diplomave dhe ka dëshmuar me audio dhe video rrugët nëpër të cilat kalojnë studentët të cilën blejnë tema të diplomës.

Përmes web-faqeve të marketingut dhe rrjeteve sociale Preportr ka kontaktuar me disa prej atyre që bëjnë dhe shesin tema të diplomës për të tjerët. Ata kanë forma të ndryshme të kontaktit, përmes numrit të telefonit, e-mailit dhe rrjetit social Facebook.

Shitësit e diplomave ofronin mundësi të ndryshme që nga punimi i një teme nga fillimi, por preferonin të na propozonin temat që i kanë të gatshme, që vetëm i duhet bërë ndërrimi i faqes së parë.

Ata shprehnin gatishmëri që të punonin tema të drejtimeve të ndryshme, pavarësisht profesionit të tyre. Çmimi për një temë të nivelit bachelor për drejtimet e fakultetit ekonomik dhe filozofik varioonte nga 150 deri në 250 euro.

Shumë shitës së temave të diplomës kishin zgjedhur web-faqe të marketingut ku reklamohen produkte të ndryshme për të zhvilluar biznesin e tyre. Preportr ka kontaktuar me disa prej tyre. Fillimisht me një grua që ishte e gatshme të na e siguronte diplomimin. Pasi i treguam se na nevojitet një temë për Fakultetin Ekonomik në drejtimin menaxhment, ajo na propozoi disa tema që i kishte të gatshme, por thoshte se mund të na e punonte edhe një temë nga fillimi.

“Temat unë i kom në shtëpi në laptop e t'i qoj me mesazh ato që i kom të gatshme, ti fol me profesorin vendos dhe më tregon. Për bachelor tema kushton 250 euro, por nëse e merr të gatshme të kushton 200 euro. Për temë të ndihmoj për ndonjë përmirësim deri sa ta pranon profesori”, thotë ajo.

Punimi dhe shitja e diplomave siç shihet është bërë biznes goxha i mirë. Kjo e ka shtyrë edhe një pensionist të merret me këtë punë. Ai ka bërë njoftime në web-faqe të marketingut për këtë shërbim. Ai ishte i gatshëm që të na përgatisë një temë diplome nga fillimi, ndërsa na premtonte që tema do të na dalë shumë e mirë dhe nuk do të ketë asnjë problem me profesorin.

Shitëse e temave të diplomës



Për bachelor tema kushton

250 euro

por nëse e merr të gatshme të kushton

200 euro

“Nuk është fare problem për ta punu një temë për sociologji. E mira kish me qenë me shkru ju temën. Shërbimi për me përpilua unë prej fillimi kuptohet është pak ma ndryshe. Unë kisha propozu mu ulë me fol më për së afërmi. Me thënë të drejtën unë nuk jam i shtrenjtë, 200 euro shkon me e përpilua unë krejt. Për master e kom 300 euro. E finalizoj krejt e ki të gatshme”, thotë ai.

Për dallim prej dy të parëve, personi i tretë që e kemi kontaktuar kishte shpallur njoftim në rrjetin social Facebook se punon tema të diplomës. Aty kishte lënë edhe një e-mail për kontakt. Bisedat e para ekipi i Preportr i ka realizuar përmes e-mailit, ku ka kërkuar informata mbi sigurimin e një teme të diplomës dhe çmimin e saj. Të nesërmen kemi pranuar një e-mail me konfirmimin se mund të na e bëjë temën e diplomës shumë shpejt.

“Po ne mundemi me ba temën! Me tregoni çfarë niveli të studimeve jeni bachelor apo master? Sa i përket çmimit për bachelor është 150 dhe përfshihet përmirësimi i temës deri sa të aprovohet! Mundesh me marr edhe me 120 euro mirëpo nuk asistoj në përmirësim”, na shkruan ai fillimisht në e-mail.

Pas disa kontakteve tjera përmes e-mailit, kemi ndërruar numrat e telefonit ku kemi diskutuar për detajet tjera rreth temës.

“Merrna me tema të ekonomisë, teknologjisë, por edhe temat sociale di me i perthoku”



Shitës i temave të diplomës

“Një temë për nivelin bachelor për sociologji e kam gati. Po du me qenë gjithçka në rregull, që me qenë edhe ti e kënaqur edhe profesori. Nuk ka ndodh që ndonjë profesor me ma refuzu ndonjë temë, por ka pasur raste kur kanë kërkuar të ndryshohet ndonjë kapitull”, thotë ai përmes telefonit.

Ekipi i Preportr ka lënë një takim me këtë person përballë Bibliotekës Kombëtare. Ai fillimisht na e prezantoi temën se çfarë përmban dhe si t’ia propozojmë profesorit në mënyrë që të marrim aprovimin për të njëjtën temë.

“Merrna me tema të ekonomisë, teknologjisë, por edhe temat sociale di me i perthoku”, thotë ai.

Gjatë takimit ai premtoi përkrahje deri në finalizimin e temës, ndërsa pagesën e kërkonte menjëherë si të aprovethe ideja e temës nga ana e profesorit.

“Me rëndësi është me ta aprovu ai titullin e temës. Kur ta aprovon mandej shkon ti i thu ky është drafti, nuk është final. Edhe ai e merr e kontrollon edhe mundet me pas naj vërejtje me heq ose me shtu diçka. Ti ato veç mi shkrun në letër ose mi tregon live apo përmes e-mailit dhe brenda një dite apo dy i kryejmë ato përmirësime”, thotë ai.

Ka edhe persona të tjerë që nuk kanë bërë shpallje për shitjen e temave të diplomës, por që këtë punë e bëjnë në rrethe më të ngushta. Preportr ka arritur që të bisedojë me një person që ka përgatitur dhe shitur tema të diplomës për kolegët e tij në fakultet.

“Tema ju kam bërë vetëm atyre që i kam njohur, disa i kam pasur kolegë të fakultetit, ka pasur raste kur dikujt që ja kam punuar një temë ma ka sjellë një shok të tij. Në përgjithësi mund të them se të gjithë atyre që ua kam përgatitur temat, ma kanë kërkuar një gjë të tillë sepse nuk kanë qenë në gjendje që ta punojnë vet temën. Ka pasur raste kur të njëjtën temë me disa ndryshime të vogla strukturore e kam bërë 3-4 herë tek i njëjti profesor brenda një viti. Por ka pasur raste kur e kam bërë një temë nga fillimi”, thotë ky person.

Disa profesorë mentorojnë deri në 80 studentë brenda vitit, disa vetëm 1

Ata që kanë vendosur të diplomojnë me tema të blera si duket nuk e kanë problem se a u pranohet tema apo jo, kjo për faktin se profesorët tek të cilët ata kanë për të diplomuar kanë numër të madh të kandidatëve dhe rrjedhimisht e kanë të pamundur të merren në detaje me secilën temë veç e veç. Në këtë mënyrë ka mundësi që shumë studentë të diplomojnë tek i njëjti profesor me temën e njëjtë. Preportr ka arritur të sigurojë numrin e temave të mentoruara për secilin profesor të fakultetit ekonomik dhe juridik në Universitetin e Prishtinës nga viti 2015 deri në maj të vitit 2017. Sipas të dhënave zyrtare nga Rektorati i UP-së, 49 profesorë të Fakultetit Ekonomik kanë mentoruar rreth 1835 tema të diplomës për dy vite e pesë muaj. Situatë thuajse e njëjtë është edhe në Fakultetin Filozofik, ku për dy vite e pesë muaj janë mentoruar 1996 tema të diplomës nga 51 profesorë.

49 profesorë të Fakultetit Ekonomik kanë mentoruar rreth **1835** tema të diplomës për dy vite e pesë muaj.

PROFESORI	BACHELOR	MASTER
Myrvete Badivuku	136	12
Nagip Skenderi	117	12
Skender Ahmeti	111	8
Nail Reshidi	97	10
Vehbi Ramaj	88	
Fatos Ukaj	79	7
Meleke Behluli	76	6
Rrustem Asllanaj	76	3
Gazmend Luboteni	74	12
Sinan Ademaj	72	5
Safet Merovci	68	7
Nexhmie Berisha	61	8
Justina Pula	56	5
Hysen Ismajli	50	8
Ymer Havolli	44	4
Muhamet Aliu	44	3
Ejup Fejza	43	
Besnik Krasniqi	36	1
Drita Konxheli	35	7
Sejdi Rexhepi	29	1
Florentina Xhelii	26	5
Arben Dërmaku	24	17
Driton Balaj	19	2
Avdullah Hoti	15	9
Driton Qehaja	13	8
Gazmend Qorraj	12	2
Adriatik Hoxha	11	
Afërdita Berisha	10	6
Enver Kutllovci	10	11
But Dedaj	9	1
Besim Beqaj	9	
Shpresa Mehmeti-Reshidi	8	
Ajet Ahmeti	8	1
Ramiz Livoreka	7	7
Mihane Berisha	7	4
Visar Rrustemi	5	7
Mujë Gjonbalaj	5	1
Armand Krasniqi	5	
Valentin Toçi	4	
Mrika Kotorri	3	
Ardiana Gashi	3	
Berim Ramosaj	3	6
Lutfi Zharku	3	1
Petrit Gashi	2	4
Rahmije Mustafa	2	5
Hykmete Bajrami	2	
Nimete Berisha	1	
Isa Mustafa		1

51 profesorë të Fakultetit Filozofik kanë mentoruar rreth **1996** tema të diplomës për dy vite e pesë muaj.

PROFESORI	BACHELOR	MASTER
Lulzim Dragidella	143	
Afrim Hoti	133	12
Januz Dërvodeli	116	21
Agim Zogaj	115	
Fadil Maloku	107	11
Mytaher Haskuka	107	20
Ukë Xhemaj	95	
Dashmir Berxulli	93	12
Zamire Hyseni	80	2
Liridona Jemini	72	
Anton Vukpalaj	52	3
Aliriza Arenliu	50	3
Selim Bezeraj	50	
Gazmend Rizaj	45	17
Afërdita Zuna	39	4
Anton Berishaj	39	8
Shemsi Krasniqi	39	6
Sejdi Rexhepi	35	2
Ibrahim Gashi	28	13
Ibrahim Berisha	27	7
Naser Zabeli	25	15
Vjollca Krasniqi	24	1
Hasnije Ilazi	23	5
Demë Hoti	21	12
Agim Hyseni	20	17
Zenun Halili	17	
Bujar Dugolli	15	24
Muhamet Qerimi	13	10
Drita Statovci	10	
Astrit Salihu	9	3
Nagip Skenderi	9	1
Kadri Metaj	9	12
Bekim Baliqi	7	1
Arben Hajrullahu	6	
Arben Hajdari	5	5
Arsim Sinani	4	4
Blerim Latifi	4	
Emine Bakalli	4	3
Ramush Mavriqi	4	
Mentor Agani	4	
Haxhi Ferati	3	
Jahja Drançolli	3	9
Selim Daci	3	6
Vlora Sylaj	2	
Majlinda Gjellaj	2	
Nita Luci	2	
Nuri Bexheti	1	
Kristë Shtufi	1	
Muhamet Mala		11
Ardita Devolli		1

Mirvetë Badivuku është profesoreshë në Fakultetin Ekonomik dhe prorektore për financa në Universitetin e Prishtinës, ku e ka edhe orarin e plotë. Pavarësisht angazhimeve të shumta, ajo del të jetë profesoresha që ka mentoruar më së shumti kandidatë për periudhën 2015-maj 2017. Në këtë periudhë ajo ka mentoruar 148 tema të diplomave, 136 prej tyre në nivelin bachelor dhe 12 në nivelin master.

Ajo thotë se pavarësisht ngarkesës së madhe, i kontrollon në detaje secilën temë deri në fazën finale.

Sipas saj, vendimi i Këshillit të Fakultetit Ekonomik që një profesor të mentorojë vetëm 50 tema brenda një viti në nivelin bachelor do të ndikojë që një pjesë e profesorëve të mos ngarkohen shumë.

“Vendimi që një profesor me i mentoru vetëm 50 tema brenda një viti e ka bërë shpërndarjen e kandidatëve tek profesorët. Është obligim i profesorit me marrë kandidatë për diplomim. Dekani i ka përcaktuar edhe komisionet që marrin pjesë në diplomim, e jo si deri tani profesori me zgjedh kë dëshiron ta ketë në komision”, ka thënë Badivuku.

Për dallim nga Badivuku ka profesorë në po të njëjtin fakultet që kanë mentoruar vetëm një ose tri tema brenda të njëjtës periudhë kohore. Ndër ta janë Isa Mustafa, i cili ka mentoruar vetëm një temë masteri, Nimete Berisha me vetëm një temë në nivelin bachelor, Hykmete Bajrami me dy tema bachelor etj. Sekretari i Universitetit të Prishtinës Esat Kelmeni ka thënë për Preportr se limiti që ka përcaktuar Fakulteti Ekonomik se një profesor mund t'i mentorojë vetëm 50 tema brenda një viti në nivelin e studimeve bachelor, mund të rritet për shkak të kërkesave të mëdha të studentëve dhe faktit se ata po mbesin në pritje për disa muaj.

Situatë thuajse e njëjtë është edhe në Fakultetin Filozofik, ku për dy vite e pesë muaj janë mentoruar 1996 tema të diplomës nga 51 profesorë.

Lulzim Dragidella është një nga profesorët që ka mentoruar më së shumti studentë në dy vitet e fundit. Tek ai në këtë periudhë kohore kanë diplomuar hiq më pak se 143 studentë të nivelit bachelor.

Dragidella ka thënë për Preportr se ndoshta ky numër aq i madh i studentëve që ka mentoruar është për shkak se ka qenë i vetmi profesor në departamentin e Punës Sociale. Megjithatë ai e pranon se kur ka aq shumë tema në mentorim, cilësia është më e dobët dhe se mund të kalojë ndonjë temë që është plagjiaturë dhe tema që e kanë blerë studentët nga ata që e kanë biznes këtë punë.

“Numri është i madh edhe i studentëve, pastaj ne jemi të angazhuar shumë edhe me orë mësimore, të gjitha këto ndikojnë në kualitetet, në mbikëqyrje, mentorim dhe kualitetin e punimeve. Nëse profesorët janë të ngarkuar, atëherë mundësia për me kalu ndonjë temë që nuk është plotësisht në rregull ekziston”, u shpreh profesori Dragidella.

Nëse profesorët janë të ngarkuar, atëherë mundësia për me kalu ndonjë temë që nuk është plotësisht në rregull ekziston

Lulzim Dragidella,
profesor në
Fakultetin Filozofik

Ai thotë se luftimi i dukurisë së shit-blerjes së temave të diplomës duhet të bëhet në mënyrë institucionale dhe të ndërmerren masa për aplikimin e teknologjisë për të parandaluar këtë dukuri.

“Është një problem që duhet me u marrë institucionet përkatëse, sepse nuk zgjidhet individualisht nga një apo dy profesorë. Në mbledhjen e fundit të Këshillit të Fakultetit Filozofik, kemi diskutuar lidhur me rëndësinë e një softueri në të cilin do të futeshin punimet sidomos të masterit”, thotë Dragidella.

Në po të njëjtin fakultet ka profesorë që kanë mentoruar vetëm një ose dy tema të diplomës përgjatë të njëjtës periudhë kohore siç është rasti i Ardita Devollit, Kristë Shtufti etj.

Krim i organizuar ndaj cilësisë së arsimit

Përkundër lulëzimit të dukurisë të shit-blerjes së temave të diplomës, institucionet e arsimit të lartë nuk kanë ndërmarë ndonjë masë konkrete për të parandaluar ose dënuar atë.

Të gjithë individët që shesin tema që ka kontaktuar Preportr kanë thënë se nuk ka ndodhur ndonjëherë që punimet e tyre të kthehen prapa ose të dyshohen për plagjiaturë. Pavarësisht që aktiviteti i tyre është i njohur, këta persona po e zhvillojnë atë pa u penguar nga askush.

Kjo edhe për faktin se shumica e profesorëve në Universitetin e Prishtinës mentorojnë shumë tema të diplomës bren-

da vitit, gjë që e bënë thuajse të pamundur të verifikohen mirë ato. Asnjë profesor deri më tani nuk e ka denoncuar në rektorat ndonjë temë diplome për plagjiaturë.

Menaxhmenti i rektoratit përmes një përgjigje me shkrim ka thënë për Preporfr se nuk është në dijeni për dukurinë e shit-blerjes së temave të diplomave. Ata kanë thënë se deri më tani nuk kanë pranuar asnjë informacion apo lajmërim, as nga profesorët dhe as nga studentët për raste të tilla, që i quajnë të shëmtuara.

“Meqenëse nuk kemi pasur raste të tilla nuk ka pasur as masa disiplinore, porse, në secilin rast që do dëshmohej një veprim i tillë, pa hezitim do merren masa sipas dispozitave statutare të UP-së. Kjo dukuri është rreptësisht e ndaluar dhe është veprim i sanksionuar me ligj dhe i ndëshkueshëm sa herë që do të vërtetohej”, thuhet në përgjigjen e menaxhmentit të UP-së. Dukagjin Pupovci njohës i çështjes së arsimit dhe profesor i angazhuar në UP, ka thënë për Preporfr se biznesi me tema të diplomës po bëhet edhe për shkak se nuk ka mbikëqyrje sa duhet nga ana e profesorëve dhe se një numër i konsiderueshëm i mentorëve mjaftohen me atë që punimin ta shohin për herë të parë në ditën e mbrojtjes së tij, në vend se ta përcjellin punën e studentit nga momenti kur e merr temën e diplomës deri në momentin kur e përfundon, duke e këshilluar dhe mbikëqyrë në mënyrë të vazhdueshme.

“Bëhet fjalë për një formë të krimit të organizuar ndaj cilësisë së arsimit. Këta që punojnë tema të diplomës me para janë kryerësit e krimit, ata që i blejnë e ndihmojnë krimin, ndërsa ata që tolerojnë një dukuri të tillë janë bashkëpjesëmarrës”, thotë Pupovci.

Ai mendon se dukuria e blerjes së temave të diplomës po ndodhë edhe për shkak të tejnqarkesës me punime të diplomës, sidomos në ato fakultete ku ka pak profesorë dhe shumë studentë. Ai thotë se në rastin më të mirë, te këta profesorë kalohet me tema me cilësi të dobët, ndërsa në rastin më të keq me tema të diplomës të blera.

“Në të dy rastet është studenti ai që e pëson më së shumti, sepse i përfundon studimet pa u aftësuar ta bëjë një hulumtim të thjeshtë dhe këtë mangësi do ta “paguajë” më vonë, kur të punësohet, respektivisht kur të ketë dëshirë për t’i vazhduar studimet”, theksoi Pupovci.

Ai thotë se duke marrë parasysh këtë situatë, UP-ja duhet të ndër marrë masa konkrete për ta parandaluar dhe luftuar këtë dukuri që e dëmton rëndë cilësinë e arsimit.

“Nga secili student duhet të kërkohet që punimin e diplomës ta dorëzojë në formë elektronike për të krijuar një databazë të punimeve të diplomës. Pastaj, me një softuer të specializuar mund të kontrollohet nëse ndonjë punim është i plagjiarizuar dhe të merren masa ndaj shkelësve të normave etike”, u shpreh profesori Pupovci.

Legjislacioni penal në Kosovë nuk parasheh vepra penale për mashtrimin akademik

Avokati Kushtrim Palushi ka thënë për Preporfr se dukuria e shit-blerjes së temave të diplomës është mashtrimi akademik nga ana e studentëve dhe krahas plagjiaturës nga ana e personelit akademik, janë dy prej problemeve kryesore që kanë të bëjnë me cilësinë e studimeve që ofron Universiteti i Prishtinës.

“Fatkeqësisht legjislacioni penal në Kosovë nuk parasheh vepra penale në lidhje me mashtrimin akademik, ndërsa definimi aktual i veprave të tjera është shumë i ngushtë për të përfshirë edhe mashtrimet që bëhen nga studentët dhe palët e treta në universitet për të arritur tituj akademik pa meritë”, thotë Palushi.

Ai thotë se statuti i UP-së në nenin 9 përcakton se “stafi akademik dhe administrativ i Universitetit dhe studentët duhet të sillen në përputhje me standardet më të larta të përkushtimit, integritetit, objektivitetit, përgjegjësisë, sinqeritetit, ndershmërisë dhe udhëheqjes.” Në anën tjetër, në bazë të nenit 23, Këshilli Drejtues i UP-së ka për detyrë të nxjerrë rregullore, ndër të tjera, edhe për “masat dhe procedurën disiplinore për personelin akademik dhe studentët”.

“Senati në anën tjetër, në bazë të nenit 48 duhet të vendos për kriteret për përjashtimin e studentëve. Deri më tash, nuk jam i sigurt nëse UP dhe organet përgjegjëse të saj kanë nxjerrë rregullore dhe politika të veçanta për verifikimin dhe sigurimin e cilësisë së temave të diplomës bachelor dhe master. Neni 117, paragrafi 2 i Statutit të UP-së thekson se punimi i diplomës për bachelor punohet individualisht nga studenti. Rrjedhimisht, nëse një student dorëzon një temë të diplomës që nuk e ka punuar ai, i njëjti është duke shkëlur rëndë këtë dispozitë të Statutit”, thotë Palushi, duke shtuar se ngjashëm neni 118, paragrafi 2, thekson se punimi i temës së diplomës për master duhet të bëhet nga studenti individualisht. Përfundimisht, neni 134 i Statutit të UP-së parasheh që senati mund t’ia heq titullin një bartësi nëse i njëjti ka falsifikuar apo mashtruar gjatë vlerësimit ose provimit, në rast të plagjiaturës apo shkeljes së të drejtës së autorit në përgatitjen e temës së diplomës apo punimit tjetër me shkrim, si dhe në rast të praktikës tjetër jo etike.

“Shitësit ose ata që hartojnë tema të diplomave për llogari të studentëve janë duke e asistuar mashtrimin akademik nga studentët dhe në rast se studentët fillojnë të japin llogari dhe të pësojnë nga veprimet e tyre dhe të shitësve të diplomave, kjo dukuri mund të zhdukët”, theksoi avokati Palushi.

Preportr

BULETIN

Preportr - Qendra Kosovare për Gazetari Hulamtuese është një projekt i filluar nga Organizata anti-korrupsion në Kosovë - ÇOHU. Projekti ka për qëllim ngritjen dhe mbështetjen e gazetarisë hulamtuese në Kosovë përmes ofrimit të një hapësire alternative për gazetarët entuziastë që të transmetojnë hulamtimet e tyre pa frikën e cenzurës.

BULETINI REDAKTOHET NGA:

Arton Demhasaj

AUTORË:

*Besnik Boletini
Leonida Molliqaj*

LEKTUROI:

Besa Kalaja

DESIGN AND LAYOUT:

envinion

TELEFONI:

038 248 506.

E-MAIL:

office@preportr.com.
preportr.cohu.org

Shënim: Organizata Çohu është anëtare e Koalicionit për Integritet dhe Transparencë në Universitet - KITU, mbështetur nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur - KFOS

Ky hulamtim është pjesë e programit të KITU-së. Pikëpamjet e shprehura në këtë hulamtim janë të Organizatës Çohu! dhe nuk paraqesin medoemos pikëpamjet e Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur - KFOS.



Organizata për
Demokraci, Antikorrupsion
dhe Dinjitet, Çohu!



KOALICIONI PËR INTEGRITET DHE
TRANSPARENCE NË UNIVERSITET



Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur
Kosovo Foundation for Open Society